



V E N D I M

Nr. 415 , datë 15.6.2022

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.793, DATË 24.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10142, DATË 15.5.2009, "PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË POLICISË SË BURGJEVE, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT E TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5, pika 1, 11, 22, 23, pika 1, 26 e 29, të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.793, datë 24.9.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, emërtimi "Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm" zëvendësohet me "Agjencia e Mbikëqyrjes Policore" dhe akronimi "SHKB" zëvendësohet me "AMP".
2. Në kreun I, "Vjetërsia në shërbim", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në paragrafin e parë, fjalët "... nr.10002, datë 6.10.2008, "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme ..." zëvendësohen me "... nr.128/2021, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore ...".

b) Pika 12 e shkronjës "A" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Periudha e shërbimit si punonjës i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore nga data e pranimit në Agjenci deri në datën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Agjencinë."

3. Në shkronjën "D", të kreut II, pas fjalëve "... të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ..." shtohen fjalët "... të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore ...".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe ministritë e institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ


MINISTRI I BRENDSHËM

BLEDAR ÇUÇI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ANDI MAHILA



NR.PROT. 3325/1
DATË 16.6. 2022

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI



3/2, 13, 14, 16, 18, 26
10 142 / 2009